



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 28101B
Datë: 26/02/2019

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), në bazë të nenit 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1. i Ligjit për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, të nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në bazë të nenit 9 paragrafi 7 të Udhëzimit administrativ nr. 11/2018 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2018/2019, nxjerr:

V E N D I M

Për kompensim të orëve të humbura gjatë grevës

1. Mësimi i humbur për shkak të ndërprerjes së përkohshme të mësimit në institucionet e arsimit parauniversitar publik, me rastin e grevës së mësimdhënësve, do të zëvendësohet si në vijim:

- 1.1 5 (pesë) ditë të zëvendësohen nga pushimi pranveror, prill 2019;
- 1.2 5 (pesë) ditë të shtunë të zëvendësohen gjatë vitit shkollor mësimor 2018/2019 dhe
- 1.3 5 (pesë) ditë të zgjatet përfundimi i vitit shkollor 2018/2019.

2. Obligohen DKA- të për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi nga data 1 mars 2019.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si dhe për shkak të ndërprerjes së përkohshme të mësimit në institucionet e arsimit parauniversitar publik, për shkak të grevës së mësimdhënësve të organizuar nga SBASHK, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/ MASHT;
2. DKA-ve;
3. Zyrës së SP/MASHT;
4. Arkivit.

